




UNIVERSITETI
BARLETI



Nr. 699 Prot, datë 08.09.2021

Nr. 1 Prot, datë 08.09.2021

Marrëveshje Bashkëpunimi

Ndërmjet

Universitetit "BARLETI"

Dhe

Orange Farmaci, Tiranë

Universiteti "Barleti" i përfaqësuar nga Prof. Dr. Suzana Guxholli dhe Orange Farmaci, rrjet farmaceutik me me shume se 40 farmaci, me NIPT L82322031K, seli ne rr. Rruga Elbasanit, Mjulle-Bathore, nr 3, Farke, Tirane, përfaqësuar nga Arjan Hamiti, administrator, në zbatim të kompetencave të tyre përkatëse, bien dakord të bashkëpunojnë për nxitjen e shkëmbimit të shumëanshëm në funksion të zhvillimit institucional.

Neni 1

Bashkëpunimi ndërmjet të dy institucioneve do të përfshijë:

- a. *Nxitjen, mbështetjen dhe realizimin e projekteve të përbashkëta;*
- b. *Shkëmbimin e ambjenteve të përbashkëta për orë laboratorike dhe ose praktika profesionale, zyra e mjedise të tjera në varësi të nevojave dhe mundësive të dy institucioneve.*
- c. *Nxitjen, mbështetjen dhe realizimin e veprimtarive të tjera shkencore (konferenca, seminare e botime në fusha me interes të dyanshëm);*
- d. *Punësimin eventual të studentëve pas diplomimit.*

Neni 2

Të dy institucionet bien dakord që realizimi i veprimtarive të mësipërme të kryhet në varësi të burimeve dhe potencialit të disponueshme nga secili institucion. Detajimi i bashkëpunimit në fushat e mësipërme (1/a-d) dhe ndjekja e zbatimit të marrëveshjes, do të realizohet nga i ngarkuari përfaqësues nga secili institucion.



UNIVERSITETI
BARLETI

ORANGE FARMACI

Neni 3

Çdo nen i kësaj marrëveshje mund të ndryshohet, të amendohet ose të revokohet në çdo kohë pas një konsultimi dhe mirëkuptimi reciprok ndërmjet të dy institucioneve.

Neni 4

Kjo marrëveshje është e vlefshme për një periudhë 3 vjeçare nga data e nënshkrimit. Ajo rinovohet automatikisht në mënyrë të heshtur, kur të dy institucionet janë dakord për këtë. Nëse njëri prej institucioneve kërkon të zgjidhë këtë marrëveshje duhet të njoftojë me shkrim jo më pak se 3 (tre) muaj përpara. Mosrinovimi i kësaj marrëveshje bëhet nëpërmjet komunikimit zyrtar nga institucioni i interesuar të paktën 3 (tre) muaj përpara përfundimit të saj.

Kjo marrëveshje hartohet në 4 (kater) kopje, në gjuhën shqipe, tekstet e saj janë autentike.

Tiranë, më datë __/__/2021

REKTORI

ADMINISTRATORI

I UNIVERSITETIT "BARLETI"

ORANGE FARMACI

PROF. DR SUZANA GUXHOLLI

ARJAN HAMITI

